

20080891670

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
LIGJIT PËR BIBLIOTEKAT

Neni 1

Në Ligjin për bibliotekat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/2004), titulli i Kreut XII "Dispozitat ndëshkuese" ndryshohet si vijon: "Dispozitat për kundërvajtje".

Neni 2

Në nenin 52, paragrafi (1) fjalët: "Me dënim me para prej 10.000 deri në 200.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:" zëvendësohen me fjalët: "Gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, i cili:".

Në paragrafin (2) fjalët: "Me dënim me para prej 10.000 deri në 30.000 denarë do të dënohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personi përgjegjës në personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "Gjobë në shumë prej 800 deri në 1.500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik".

Paragrafi (3) fshihet.

Paragrafi (4) që bëhet paragraf (3) ndryshohet si vijon:

"(3) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) pika 5 e këtij neni personit juridik mund t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje konfiskimi i sendeve që janë përfutur me kryerjen e kundërvajtjes."

Neni 3

Pas nenit 52 shtohen dy nëntituj të rinj dhe dy nene të reja 52-a dhe 52-b, si vijojnë:

"Organi për kundërvajtje

Neni 52-a

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 52 të këtij ligji, procedurën për kundërvajtje e mban dhe sanksionin për kundërvajtje e kumton organi i administratës shtetërore, kompetent për punët në sferën e kulturës (në tekstin e mëtejme: Organi për kundërvajtje).

(2) Procedurën për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni para organit për kundërvajtje e mban Komisioni për vendosje sipas kundërvajtjes (në tekstin e mëtejme: Komisioni për kundërvajtje), i formuar nga ana e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës.

(3) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga persona zyrtarë të autorizuar, të punësuar në organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në sferën e kulturës, prej të cilëve njëri e kryen funksionin e kryetarit të Komisionit për kundërvajtje.

(4) Komisioni për kundërvajtje përbëhet nga tre anëtarë edhe atë:

- dy juristë të diplomuar, prej të cilëve njëri me provimin e dhënë të jurisprudencës, me pesë vjet përvojë pune në fushën e vet dhe

- një anëtar me përgatitje profesionale sipërore nga sfera e shkencave shoqërore me pesë vjet përvojë pune në fushën e vet.

(5) Komisioni për kundërvajtje zgjidhet me kohëzgjatje prej tre vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje të anëtarëve.

(6) Kryetar i Komisionit për kundërvajtje mund të zgjidhet vetëm juristi i diplomuar.

(7) Komisioni për kundërvajtje për Organin për kundërvajtje vendos për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj dhe me ligj tjetër dhe kumton sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj, me Ligjin për kundërvajtje dhe/ose me ligj tjetër.

(8) Përveç anëtarëve të Komisionit për kundërvajtje, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve në sferën e kulturës, mund të përcaktojë sekretar të Komisionit për kundërvajtje i cili kryen punët administrative të Komisionit dhe zëvendësanëtarë, të cilët me përjashtim, marrin pjesë në punën e Komisionit për kundërvajtje në rast të mungesës së ndonjërit nga anëtarët.

(9) Komisioni për kundërvajtje miraton rregullore për punën e vet.

(10) Kundër aktvendimeve të Komisionit për kundërvajtje, me të cilat kumtohet sanksion për kundërvajtje, mund të paraqitet ankesë për ngritjen e kontestit administrativ para gjyqit kompetent.

Barazimi Neni 52-b

(1) Për kundërvajtjet në nenin 52 të këtij ligji, inspektorët e kulturës janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim para se të paraqesin kërkesë për procedurë për kundërvajtje.

(2) Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet për ngritjen e procedurës për barazim, inspektorët e kulturës përpilojnë procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e hasur në vendin e ngjarjes.

(3) Në procesverbal përcaktohet mënyra me të cilën do të mënjanohej pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si edhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kryerja e kundërvajtjes.

(4) Inspektori i kulturës në procedurën për barazimin kryerësit të kundërvajtjes mund t'i japë urdhërpagesë.

(5) Në qoftë se kryerësi e pranon urdhërpagesën, është i obliguar që të njëjtën ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës për kryerësin e kundërvajtjes, shënohet në procesverbal.

(6) Kur si kryerësi i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën e nënshkruan personi zyrtar, gjegjësisht përgjegjës i cili është hasur në vendin e ngjarjes gjatë mbikëqyrjes inspektuese ose person tjetër zyrtar ose përgjegjës i cili ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhërpagesën.

(7) Deklarata nga paragrafi (6) i këtij neni shënohet në procesverbal.

(8) Inspektorët e kulturës janë të obliguar që të mbajnë evidencë për procedurat e ngritura për barazim dhe për përfundimin e tyre.”

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.